



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 24.17.1-2017-08**

## **RAPORTI I AUDITIMIT**

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AKADEMISË SË  
DREJTËSISË PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, maj 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Akademisë së Drejtësisë në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Shpresa Zenelaj (Udhëheqëse ekipi) dhe Burbuqe Idrizi (Anëtare e ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Ramadan Gashi.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
5 Qeverisja e mirë.....	17
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	19
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraparak dhe vitet e mëhershme .....	22
Shtojca III: Letërkonfirmimi .....	24

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 07.02.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Akademisë së Drejtësisë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Akademisë së Drejtësisë për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

#### **Theksimi i çështjes**

Vlera e pasurive nën 1,000€ e prezantuar në PFV (13,022€) nuk është e plotë dhe e saktë për shkak se Akademia e Drejtësisë nuk i kishte përfshirë pasuritë jo kapitale të pranuar si donacion nga Bashkimi Evropian në vitin 2015 në regjistrat e pasurisë.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e Kryesuesit të Këshillit- auditimi 2017**

Kryesuesi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Akademisë së Drejtësisë. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Akademisë së Drejtësisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë për të mbështetur opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Akademisë së Drejtësisë (AD-së) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësim dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, nr.01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se regjistri i pasurive jo financiare nën 1,000€ nuk është i plotë dhe i saktë. Ky regjistër nuk përmban vlerën e pajisjeve të pranuar si donacion nga Bashkimi Evropian në vitin 2015, si (649 libra, 1 Smart Software, 18 Llaptop, 5 kompjuter, 25 tavolina, 39 ulëse dhe pajisje tjera). Përkundër përpjekjeve nga institucioni për sigurimin e

informatave për vlerën financiare të këtyre aseteve një gjë e tillë nuk ishte siguruar nga donatori. Përkundër kësaj, AD nuk kishte formuar një komision të veçantë për vlerësimin e këtyre aseteve, siç kërkohet me Rregulloren e MF-it nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV**

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Këshillit Drejtues është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Akademisë së Drejtësisë.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve.**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.



---

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Akademia e Drejtësisë kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2017; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Nga aspekti i cilësisë, PFV-të nuk përmbanin gabime dhe mangësi informatash, me përjashtim të çështjes së pasurive për të cilat ne e kemi theksuar opinionin.

### DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I AKADEMISË SË DREJTËSISË

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale, përveç çështjes së paraqitur te theksimi i çështjes.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi 1** Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojnë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet e ngritura në raport. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e PVF-ve në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në regjistrimin e pasurive.

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

#### Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Menaxhimi financiar dhe kontrolli efektiv kërkojnë procese të rishikimit dhe udhëzues përcjellës të cilët sigurojnë zbatimin e plotë të ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe proceseve të tjera të kontrollit. Akademia e Drejtësisë ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutorë të saj. Vlen të theksohet se procedurat e prokurimit publik janë zhvilluar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) siç parashihet me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP). Sfidë për institucionin edhe me tutje mbetet mbulimi i pozitës kyçe (Drejtor për Administratë dhe Financa) me ushtrues detyre jashtë afatit të paraparë ligjor si dhe menaxhimi i pasurisë.

#### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>663,884</b>	<b>619,390</b>	<b>516,769</b>	<b>438,994</b>	<b>504,318</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	663,884	603,197	515,672	427,699	491,689
Donacionet e jashtme	0	16,193	1,097	11,295	12,629

Buxheti final në raport me atë fillestar ishte reduktuar për 44,494€. Kjo diferencë është si rezultat i reduktimit të grantit qeveritar (60,687€) pas rishikimit buxhetor dhe me vendime të Qeverisë<sup>2</sup> si dhe rritjeve nga donacionet e jashtme (16,193€).

AD-ja ka pranuar grante nga donatorët e jashtëm në vlerën prej 16,193€ (nga Këshilli i Evropës 14,466€ dhe GIZ<sup>3</sup> 1,727€). Nga donacioni i Këshillit të Evropës ishin shpenzuar vetëm 1,097€ apo 7%, kjo pasi që për vitin 2017 ishte paraparë vetëm një aktivitet për të financuar mbështetjen për

<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

<sup>2</sup> Vendimi nr 10/19 i datës 15.12.2017 dhe vendimi nr 01/21 i datës 22.12.2017

<sup>3</sup> Deutsche Gesellschaft Internationale Zusammenarbeit.

trajnimet profesionale që mbahen në AD, ndërsa marrëveshja përfundon me 31.12.2018. Marrëveshja me GIZ (implementimi i programit të trajnimit për orientimin e gjyqtarëve të dekretuar nga komuniteti jo shumicë) ishte nënshkruar me 15.12.2017 dhe nuk ishte kryer asnjë shpenzim.

Në vitin 2017, AD ka shpenzuar 83% të buxhetit final ose 516,769€, që është më ulët për 16% krahasuar me vitin 2016 ishte 99%. Shkalla aktuale e realizimit të buxhetit është e ndikuar nga realizimi jo i kënaqshëm i mallrave dhe shërbimeve dhe shërbimeve komunale. Arsyet janë vonesat në zhvillimin e aktiviteteve të prokurimit dhe lidhja e kontratave (servisim dhe mirëmbajtje, akomodim, ushqim dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime) nga ana e AQP-së në periudhën e fund vitit 2017.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	663,884	619,390	516,769	438,994	504,318
Pagat dhe Mëditjet	204,384	204,384	185,825	183,460	188,960
Mallrat dhe Shërbimet	430,000	390,765	310,945	245,783	303,551
Shërbimet komunale	16,500	14,500	10,258	9,751	11,808
Investimet Kapitale	13,000	9,741	9,741	0	0

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Kategoria e pagave dhe mëditje nuk kishte ndryshime në mes të buxhetit fillestar dhe atij final. Teprica e mjeteve financiare në fund të vitit (18,559€) ishte si pasojë pasi që tre (3) zyrtarë kishin dhënë dorëheqje gjatë vitit 2017 dhe një (1) pozitë kishte mbetur e pa plotësuar për staf të rregullt;
- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte reduktuar për 39,235€. Shpenzimet kryesore tek kjo kategori janë shpenzimet e trajnimit. Dekretimi i gjyqtarëve të rekrutuar në vitin 2016 është bërë në muajin korrik 2017, si rezultat i kësaj trajnimi fillestar për gjyqtarët e rinj ka filluar në shtator. Kjo ka ndikuar që shpenzimi i kësaj kategorie të jetë 80% e buxhetit final;
- Shkurtime buxhetore për shërbimet komunale ishin bërë me rishikim buxhetor për vlerën 2,000€. Realizimi i buxhetit final për këtë kategori ishte 70%. Sipas pohimeve të zyrtarëve, kjo është si rrjedhojë e stabilitetit të energjisë elektrike në vitin 2017 dhe zvogëlimit të shpenzimeve tek telefonat fiks; dhe
- Buxheti tek kategoria e investimeve kapitale me rishikimi buxhetor, ishte reduktuar për 3,259€, ndërsa shpenzimi në këtë kategori ishte në masën 100%.

## 3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative. Ne testuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e pagave (punëtorët aktual, rekrutimet, largimet, pushimet e lehonave dhe pensionet). Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës.

### Çështja 2 – Pagesat e pushimit të lehonisë

**E gjetura** Rregullorja 06/2011, neni 12, përcakton se (6) gjashtë muajt e parë të pushimit të lehonisë, nëpunësja paguhet nga institucioni me kompensim 70% të pagës bazë. Gjatë testimit të tre (3) rasteve të shfrytëzimit të pushimit të lehonisë gjatë vitit 2017, ne kemi vërejtur se të punësuarat ishin (paguar) kompensuar me shtesën e SHCK-së prej 30€ në muaj në periudhën e parë të shfrytëzimit të pushimit të lehonisë.

**Rreziku** Mos ndalesat e shtesave gjatë pushimit të lehonisë dhe pagesat e tilla jo përputhje me rregulloret në fuqi, rrezikojnë që me rastin e kompensimit të lehonave të dëmtohet buxheti i AD-së.

**Rekomandimi 2** Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojnë se në rastet e shfrytëzimit të pushimit të lehonisë, kompensimet të bëhen në harmoni të plotë me kërkesat ligjore dhe të sigurojnë në bashkëpunim me MAP vendosjen e kontrolleve të shtuara për të parandaluar gabimet e identifikuar në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.

## 3.3 Menaxhimi i personelit

Në Akademinë e Drejtësisë numri i aprovuar i stafit për vitin 2017 ishte 25 pozita, mirëpo në fund vitit kanë mbetur katër (4) pozita të lira. Kjo ka ndodhur për shkak se tre (3) të punësuar kanë dhënë dorëheqje dhe një (1) pozitë ka qenë e lirë gjatë gjithë vitit. Arsyeja e mos rekrutimit të stafit në këto pozita të lira është se Akademia e Drejtësisë është në proces të ristrukturimit për shkak të transformimit nga Instituti Gjyqësor i Kosovës në Akademi të Drejtësisë.

---

**Çështja 3 - Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre (UD)**

- E gjetura** Ligji për Shërbimin Civil i Republikës së Kosovës nr.03L/149, përcakton se në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës (UD) nuk mund të emërohet më gjatë se 3 (tre) muaj.
- Pozita e Drejtorit për Administratë dhe Financa vazhdon të mbulohet me U.D nga data 06/12/2016. Kjo ka ndodhur pasi që zyrtarja e angazhuar si U.D në këtë pozitë, ishte në pushim të lehonisë, ndërsa pas përfundimit të pushimit kishte dhënë dorëheqje. Si rrjedhojë, kjo pozitë vazhdon të mbulohet me UD deri në ristrukturim të plotë të AD-së. Për këtë çështje ne kemi rekomanduar edhe në vitin e kaluar, mirëpo kjo praktikë mbetet edhe më tutje sfidë për plotësimin me staf të rregullt të pozitave që mbulohen me UD.
- Rreziku** Praktika e mbulimit të pozitave kyçe me U.D për periudha të gjata kohore përveç se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme. Kjo mund të ndikojë negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin e procedurave për mbulimin e pozitave të cilat po funksionojnë me ushtrues detyre (UD). Kohëzgjatja e funksionit si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.

---

### 3.4 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime edhe shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 405,265€. Prej tyre janë shpenzuar 321,203€. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këto kategori përfshijnë shpenzimet e arsimit dhe trajnimit, shpenzimet e qerasë, shpenzimet e botimeve dhe publikimeve, shpenzimet e udhëtimeve për vizita studimore dhe shpenzimet komunale.

LPP nr.04/L-042 (me ndryshime dhe plotësime), neni 21a përcakton se për qëllime të ekonomizimit të aktiviteteve të prokurimit, për Agjencitë e Pavarura të cilat i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, që kanë më pak se 50 (pesëdhjetë) punonjës, procedurat e prokurimit i kryen Agjencia Qendrore e Prokurimit ( AQP-ja). AQP kishte realizuar 11 (njëmbëdhjetë) nga 20 (njëzetë) kontratat e planifikuara me plan të prokurimit për vitin 2017 nga Akademia e Drejtësisë. Në këtë nivel të realizimit kishin ndikuar vonesat e fillimit të procedurave për disa prokurime dhe lidhja e kontratave (servisim dhe mirëmbajtje, akomodim, ushqim dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime) nga ana e AQP-së në periudhën e fund vitit 2017.

Në mostrat e ekzaminuara nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 9,751€, i cili ishte shpenzuar në tërësi. Shpenzimet kishin të bëjnë me furnizim me pajisje të përkthimit. Për mostrat e testuara nuk kemi ndonjë çështje për t'u raportuar.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencës është në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores së MF nr.02/2013, për menaxhimin e pasurisë jo financiare të organizatave buxhetore.

Në PVF Akademia e Drejtësisë kishte prezantuar pasurinë mbi 1,000€ në vlerë 9,064€, ndërsa pasuria jo-kapitale nën 1,000€ ishte në vlerë 13,022€. Përveç kësaj, 95% e pasurive kapitale të

regjistruara në regjistrin kontabël në SIMFK dhe 80% e pasurive jo kapitale të regjistruara në regjistrin E-pasuria janë me vlerë zero.

Përkundër implementimit të rekomandimeve të vitit të kaluar lidhur me pasuritë (aplikimi i zhvlerësimeve tek pasuria jo kapitale nën 1,000€ dhe formimit të komisioneve për inventarizim dhe vlerësim), AD ende nuk ka arritë ta ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurisë. Dobësitë janë të theksuara më poshtë.

#### Çështja 4 – Regjistër jo i plotë i pasurive jo financiare

**E gjetura** Me vendimet e datës 13.11.2017<sup>4</sup>, Drejtori Ekzekutiv kishte formuar komisionet për inventarizim dhe vlerësim të pasurive, të cilët kishin evidentuar disa pasuri të cilat figurojnë në regjistër ndërsa janë asgjësuar. Ne testuam tri mostra (dy kompjuter dhe një printer) nga komisioni i inventarizimit. Edhe pse komisioni i vlerësimit kishte konstatuar se janë jashtë përdorimit (të asgjësuar në vitin 2014), ne kemi vërejtur se këto pajisje nuk ishin larguar nga regjistrat e pasurive. Kjo ka ndodhur për arsye se Komisioni nuk e kishte përfunduar punën deri me 29.01.2017, dhe si rrjedhojë raporti i pasurive nuk është i harmonizuar me raportin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurisë.

**Rreziku** Mos harmonizimi i regjistrave të pasurisë ka ndikuar në mos largimin e gjithë pasurive që janë jashtë përdorimit nga këta regjistra, dhe e gjithë kjo ka ndikuar direkt në mbivlerësim të pasurisë së AD-së.

**Rekomandimi 4** Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet sigurojnë që komisioni për inventarizim dhe vlerësim të pasurive përfundojnë detyrat e ngarkuar me kohe, dhe bëjnë vlerësimin e drejtë dhe të plotë të të gjithë pasurive jo financiare, si dhe harmonizojnë raportet e vlerësimit dhe inventarizimit të cilat i paraprijnë paraqitjes së të dhënave të sakta të pasuri në PFV.

### 3.7 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paraja e gatshme ishte menaxhuar në harmoni me rregullën 01/2013 për shpenzimin e parave publike. Te gjitha transaksionet e parave të imëta ishin regjistruar në llogarinë përkatëse me rastin e arsyetimit të shpenzimeve të bëra nga fondi i parave të imëta.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

<sup>4</sup> Vendimi nr 02/267/2017 për komision të inventarizimit dhe vendimi nr 02/268/2017 për komision të vlerësimit

---

### 3.8 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 2,889€, këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Arsyeja e mos pagesës ishte pranimi i faturave pas kalimit të afatit të zotimit.

Akademia e Drejtësisë ka një sistem të mirë kontrolli për menaxhimin e pagesave dhe raportimi i obligimeve ishte bërë në baza të rregullta mujore në thesar.

Përjashtimisht kësaj, raporti i obligimeve të papaguara përmbante tetë fatura në vlerë prej 2,335€ të pranuar në janar të vitit 2018. Kjo shpalesje nuk ishte në përputhje me Rregulloren 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar- nenit 17 ku përcakton se Organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të Institutit Gjyqësor të Kosovës (tani Akademia e Drejtësisë), ka rezultuar në tre rekomandime. AD me 30 korrik 2017 kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, tre rekomandime ishin në proces të zbatimit. Ndërsa tre nga katër rekomandimet e viti 2015 ishin zbatuar në vitin 2016 dhe një ishte bartur në vitin 2017, ku i njëjti ishte zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.



---

## 5 Qeverisja e mirë

### Hyrje

Qeverisja e mirë përfshin parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimi i rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe zhvillimi i qeverisjes së mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërme të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Pyetësi i vet-vlerësimit, i plotësuar nga AD, e pasqyron gjendjen aktuale. AD është në proces të zbatimit të rekomandimeve si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Në bazë të dëshmive të ofruara për disa rreziqe të përcaktuara në regjistrin e rreziqeve, ne vërejtëm që AD kishte marre veprime konkrete në menaxhimin (monitorimin) e atyre e rreziqeve, mirëpo të njëjtat nuk ishin bërë në baza të rregullta (rekomandohet në baza tre mujore) dhe nuk ishin përmbledhur në ndonjë raport për menaxhimin e tyre siç e kërkon procedura nr.4 e MFK-së. Mungesa e strategjisë gjithëpërfshirëse është dobësi e mjedisit të kontrollit. Numri i vogël i stafit paraqet sfidë për AD-në në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi.

#### 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollat e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Në bazë të UA Nr.23/2009 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm, Akademia e Drejtësisë nuk i plotëson kriteret (mbi 1 milion buxhet, 50 staf të punësuar, si dhe shkallë të lartë të rrezikshmërisë) për themelimin e NjAB-së.

Në mungesë të NjAB-së, auditimi i brendshëm kryhet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm (DAB) në kuadër të Ministrisë së Financave (MF), mirëpo gjatë vitit 2017 nuk ishte zhvilluar ndonjë proces i auditimit të brendshëm nga DAB për AD-në. Ne inkurajojmë menaxhmentin që të bëjë një rishikim të nevojave për auditim të brendshëm dhe të konsiderojë mundësinë e arritjes së një marrëveshje me ndonjë organizatë tjetër të sektorit publik që të shfrytëzojë shërbimet e auditimit të brendshëm.

### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

## **5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut**

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

### **Çështja 5 - Mos aprovimi i planit strategjik**

**E gjetura** Plani Strategjik i AD-së ishte hartuar (draftuar), mirëpo ende nuk ishte aprovuar. Arsyeja e mos aprovimit të planit strategjik kishte të bënte me faktin se hartimi i strategjisë ishte mbështetur nga këshilltarët e jashtëm dhe si rezultat i kësaj, procesi i harmonizimit të dokumentit në mes të dy palëve (vendore dhe jashtme) kishte marrë shumë kohë. Megjithatë, objektivat strategjike për vitin 2017 ishin paraparë në Programin e Punës për vitin 2017.

**Rreziku** Mungesa e planit të aprovuar strategjik, pamundëson trajtimin e çështjeve të cilat janë të domosdoshme për përmirësimin e efikasitetit dhe monitorimin e progresit drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara në periudha afatgjate.

**Rekomandimi 5** Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojnë aprovimin e strategjisë zhvillimore dhe një plan/proces të dokumentuar dhe efektiv të monitorimit të objektivave të përcaktuara.

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
3.5.2 Kompensimet (pagat/mëditjet).	Kryetari i Këshillit Drejtues duhet të vazhdoj përpjekjet që në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të siguroj se listat e pagave (payroll) janë të përgatitura në pajtueshmëri me Akt emërimet për secilin të punësuar, përfshirë pozitën dhe koeficientin e pagesës.	Po, rekomandimi është zbatuar.		
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
2.2 Pyetësi i vet vlerësimit të komponentëve të MFK-së.	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë hartimin e strategjisë zhvillimore dhe një plan/proces të dokumentuar dhe efektiv të monitorimit të arritjes së objektivave. Po ashtu të siguroj se është rishikuar plotësimi i saktë i pyetësit të vetëvlerësimit, dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive dhe ekziston dokumentacioni mbështetës për këtë proces.		Strategjia zhvillimore ishte hartuar në vitin 2017, mirëpo si e tillë e njëjta akoma nuk ishte aprovuar.	

3.2 Paga dhe Mëditje	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë mbulimin e rregullt të pozitave kyçe të institucionit të cilat janë me UD, duke zhvilluar procedurat sipas kërkesave ligjore.		Ky rekomandim ishte në proces të zbatimit sepse fenomeni i mbulimit të pozitave me UD me gjatë se sa është e lejuar me ligj ishte prezent edhe në vitin 2017. Mirëpo kjo gjendje ishte për shkak të procesit të ristrukturimit të AD-së që ndërlidhet direkt me procesin e aprovimit të strategjisë nga këshilli drejtues.	
3.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryesuesi i Këshillit Drejtues duhet të sigurojë që regjistrat e pasurisë të jenë të plotë dhe të përfshijnë pasurinë që e menaxhon IGJK-ja (tani e tutje AD-ja). Drejtori të formojë komisionin e inventarizimit të pasurisë me kohë me qëllim që raporti i inventarizimit t'i paraprijë përgatitjes së PFV-ve.		AD kishte formuar komisionet për inventarizim dhe vlerësim, mirëpo regjistrat e pasurive nuk ishin të plotë sepse nuk përfshinin pasuritë e dhuruara nga donatorët e jashtëm.	

## Shtojca III: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA АКАДЕМИЈА ПРАВДЕ - ACADEMY OF JUSTICE			
Nr. Doku. U. D. Kodin. Org. Unit	02	Nr. Prot. Uz. Prot. Prot. No.	86
Nr. Fajvës Nr. Stranica No. Pages	1	Data Datum Date	23.04.2018
Prishtinë / a			



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova/Republic of Kosovo**

*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 23.04.2018

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit Financiar të Akademisë së Drejtësisë për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Drejtori Ekzekutiv i AD-së: Valon Kurtaj

Salom